



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 73, datë 1.6.2020



PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut të jetë, gjithsej, 80 veta.
4. Urdhri nr.86, datë 16.5.2016, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

STRUKTURA E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIQYRJES SË TREGUT

